

Dokument për politika publike

**Sfidat kryesore në
prokurimin publik të
ndërmarrjeve
shtetërore**

- **Botim elektronik:**

Sfidat kryesore në prokurimin publik të ndërmarrjeve shtetërore

- **Botues:**

Qendra për Komunikime Civile

- **Përkthimi:**

Eniena Aeti

- **Dizajn-grafik:**

Qendra për Komunikime Civile

Dokumenti për politika publike është përgatitur në kuadër të projektit “Drejt Ndërmarrjeve Publike Llogaridhënëse” me ndihmë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, zbatuar nga Qendra për Komunikime Civile, në periudhën nga 1 tetor 2019 deri më 30 shtator, 2021.

HYRJE	4
SFIDAT KRYESORE	6
1. Niveli i ulët i realizimit të planeve për prokurim publik	6
2. Konkurrenca e vogël në procedurat e prokurimit publik	7
3. Llogaridhënia e pamjaftueshme për marrëveshjet e lidhura dhe zbatimin e tyre	8
BALLAFAQIMI ME SFIDAT	9
1. Përmirësimi i prokurimit publik në fazën e planifikimit	9
2. Ndërmarrja e masave për të rritur konkurrencën	10
3. Nxitja e transparencës së marrëveshjeve të lidhura dhe realizimi i tyre	10

Sfidat kryesore në prokurimin publik të ndërmarrjeve shtetërore janë identifikuar në bazë të sërë aktiviteteve të zbatuara në periudhën e kaluar në kuadër të projektit “Drejt Ndërmarrjeve Publike Llogaridhënëse”. Projekti që u zbatua në periudhën prej tetor 2019 deri në shtator 2021 dhe përfshiu aktivitetet e rezultatet në vijim:

- ✓ Janë lokalizuar rreziqet e korrupsionit në të gjitha fazat e prokurimit publik, për të cilat ne analizuam thellësisht 167 tenderë dhe të dhëna të referuara nga gjithsej 3,342 kontrata për prokurim publik të zbatuara nga 37 kompani të themeluara nga Qeveria, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Gostivarit, Kavadarit dhe Strugës.
- ✓ Për secilën prej këtyre kompanive u zhvillua kontroll individual mbi mënyrën e kryerjes së prokurimit publik.
- ✓ U përgatitën “Tregues për matjen e rreziqeve nga korrupsioni” dhe “Propozime për zvogëlimin e korrupsionit në prokurimin publik”, të cilat u diskutuan me 130 përfaqësues dhe themelues të kompanive.
- ✓ Një pjesë e propozimeve të dhëna - Qeveria i ka përfshirë në Planin Kundër Korrupsionit - Veprimi 21. Bëhet fjalë për futjen e procedurave për kryerjen e prokurimit publik, miratimin e planeve për integritet ose programeve kundër korrupsionit, marrjen e masave për stimulimin e konkurrencës, rritjen e llogaridhënies në lidhje me prokurimin publik, etj.
- ✓ Pastaj u zhvillua një program edukativ për forcimin e aftësive për zhvillimin e tenderëve, me 46 persona që kryenin prokurim publik në kompanitë dhe komunat e përfshira.
- ✓ Përveç kësaj, 30 persona u trajnuan për të zhvilluar plane integriteti në prokurim publik, dhe disa kompani përdorën ndihmë mentorimi për të zhvilluar planet e tyre të integritetit.
- ✓ Nëpërmjet përpunimit të të dhënave nga gjithsej 5,018 kontrata të prokurimit publik të kompanive të përfshira në vitin 2020 dhe 2021, ne matëm përparimin e bërë në këto dy vite.

Të gjitha hulumtimet e kryera në periudhën e kaluar tregojnë se ka korrupsion në prokurimin publik dhe se disa prej tenderëve janë kryer në kundërshtim me parimet themelore të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik. Nga ana tjetër, vetë autoritetet kontraktuese janë relativisht pasive sa i përket raportimit të keqpërdorimit në prokurimin publik.

Gjatë kësaj, është e rëndësishme të kihet parasysh se kompanitë e themeluara nga Qeveria, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Gostivarit, Kavadarit dhe Strugës në vitin 2020 kanë lidhur 3,466 kontrata me vlerë totale prej rreth 15 miliardë denarë ose rreth 242 milion euro. Është e mundur që kjo shumë të tejkalohet në vitin 2021, duke qenë se në gjashtë muajt e parë janë lidhur 1.552 kontrata në vlerë të përgjithshme prej 9 miliardë denarë ose 145 milionë euro. Vlera e lartë është një nga argumentet kryesore në mbështetje të rëndësisë së çështjes së mënyrës së kryerjes së prokurimit publik nga këto kompani.

Energjia për ngushtimin e hapësirës për korrupsion dhe për zvogëlimin e mundësive për keqpërdorim të burimeve publike është e dukshme në shumicën e personave të prokurimit publik në ndërmarrjet e themeluara nga Qeveria, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Gostivarit, Strugës dhe Kavadarit. Por lufta kundër korrupsionit në prokurimin publik kërkon përfshirjen jo vetëm të njëjësive organizative përgjegjëse për prokurim publik, por edhe të të gjithë ndërmarrjeve dhe madje edhe publikut të gjerë.

Duhet të bëhen përpjekje për të rritur presionin ndaj organeve drejtuese të korporatave për të menaxhuar me burimet e besuara në mënyrë ligjore dhe ekonomike, pa i keqpërdorur ato për qëllime personale dhe partiake. Presioni duhet të vijë nga brenda, pra nga punonjësit në kompani, por edhe nga jashtë organeve të pavarura rregullatore dhe organeve të zbatimit të ligjit, si dhe nga përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave.

Qeveria mbështeti propozimin nga institucionet për të kërkuar miratimin e programeve kundër korrupsionit ose planeve për integritet. Ndërsa ne nuk mund të presim që ata të zgjidhin problemet brenda natës, ato prapëseprapë mund të jenë boshti rreth të cilit mund të rrisim presionin duke kërkuar përgjigje dhe llogaridhënie nga strukturat drejtuese që kanë planifikuar të marrin përsipër zvogëlimin e rreziqeve nga korrupsioni dhe të pyesim se çfarë hapash kanë ndërmarr në të vërtetë.

Projekti “Drejt Ndërmarrjeve Publike Llogaridhënëse” zbatohet nga Qendra për Komunikime Civile, me ndihmë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup.

Gjeneratorët e korrupsionit në të gjitha fazat e prokurimit publik të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare të themeluara nga Qeveria dhe NJVL-të janë paraqitur saktësisht në hulumtimin “Hartimi i rreziqeve nga korrupsioni në prokurimin publik të ndërmarrjeve në pronësi të Qeverisë dhe komunave”[1]. Si përgjigje e dobësive dhe rreziqeve të identifikuara në kuadër të projektit “Drejt Ndërmarrjeve Publike Llogaridhënese”, u përgatitën “Propozime për zvogëlimin e korrupsionit në prokurimin publik dhe përmirësimin e mënyrës së zbatimit të tyre”, të cilat ishin subjekt i konsultimeve të gjera me grupet e interesit dhe iu dorëzuan të gjitha kompanive të përfshira në projekt, por edhe institucioneve tjera përkatëse në vend.

Prandaj, ky dokument politikash synon të nxjerrë në pah sfidat kryesore në procesin e prokurimit publik në njërin nga tre fazat - planifikimin e prokurimit, zbatimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave të prokurimit publik. Këto janë sfidat e mëposhtme:

1. Niveli i ulët i realizimit të planeve për prokurim publik
2. Konkurrenca e vogël në procedurat e prokurimit publik
3. Llogaridhënia e pamjaftueshme për marrëveshjet e lidhura dhe zbatimin e tyre

1. Niveli i ulët i realizimit të planeve për prokurim publik

Realizimi mesatar i planeve për prokurim publik të ndërmarrjeve publike të synuara dhe shoqërive aksionare në vitin 2019 ishte 54%. Në vitin 2020, kjo përqindje është edhe më e ulët dhe është 47%. Trendi negativ vazhdon në gjashtë muajt e parë të 2021 dhe është vetëm 44%. Kriza e pandemisë me KOVID-19 sigurisht që ka ndikim në këto prirje negative, por është vërtet e vështirë të matet ai efekt me saktësi.

Niveli i ulët i realizimit të tyre të planeve për prokurim publik përcillet me ndryshime të shpeshta të planeve. Përkundër kësaj shtate, shumica e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare pohojnë se kanë sistem të vendosur për monitorimin e zbatimit të planit të prokurimit. Disa prej tyre kanë shërbim operacional të veçantë për atë qëllim, të tjerët, kryejnë analiza të hollësishme në tabelat e MS Excel, përmes të cilave ata aktualisht monitorojnë dhe regjistrojnë zbatimin e planit, dhe tek të tjerët këshillat vendosin se cili do të jetë zbatimi i tij.

Ndryshimet e shpeshta në planin e prokurimit publik dhe mungesa e një sistemi për monitorim të zbatimit të tij flasin për planifikim të dobët të prokurimit publik dhe menaxhim joefikas të fondeve publike. Në një numër të vogël rastesh, ndryshimet mund të justifikohen nga rrethana objektive që lidhen me aktivitetet e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve planet ndryshojnë sepse në përgatitjen e tyre fillestare nuk është kushtuar vëmendje e mjaftueshme për të përcaktuar nëse ka nevojë dhe mundësi për prokurimin specifik dhe të përcaktohet vlera e tij, dhe madje më shpesh problemi ka të bëjë me mos-planifikim afatmesëm në kuptimin që disa aktivitete ose ngjarje rezultojnë me nevojë për lëndë të veçantë të prokurimit.

[1] <https://www.opendata.mk/Home/TekstualniDetails/103?Category=2>

Faza e planifikimit të prokurimit si një nga tre fazat kryesore - përveç zbatimit të tenderëve dhe zbatimit të kontratave, është veçanërisht e rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të procedurave të prokurimit publik dhe lidhjen e kontratave.

Në këtë mënyrë, planifikimi i suksesshëm i prokurimit publik sintetizon një numër aspektesh të rëndësishme, siç është përcaktimi i përshtatshëm i prokurimit të nevojshëm, gjegjësisht të mallrave, shërbimeve dhe sendeve që duhet të prokurohen, pastaj përcaktimi i saktë i vlerës së caktuar të prokurimit dhe në fund, vendosja e duhur e kornizës kohore të prokurimit. Rëndësia e planifikimit të prokurimit buron nga fakti se në këtë fazë janë hedhur themelet mbi të cilat varet e gjithë rrjedha e procedurës dhe suksesi në plotësimin e nevojave. Gjithashtu, një aspekt i rëndësishëm është se vetëm një pjesë e vogël e planifikimit mbulohet nga rregullores për prokurim publik, e cila, mbi të gjitha, i referohet fazës së mesme, pra zhvillimit të vetë procedurës deri në përfundimin e kontratës së prokurimit publik. Prandaj, planifikimi është një fazë që varet shumë nga integriteti, angazhimi dhe profesionalizmi i personave në autoritetet kontraktuese, dhe jo vetëm nga ata të përfshirë në prokurimin publik. Prandaj, planifikimi shpesh rregullohet me akte nënligjore, por edhe me akte të brendshme të institucioneve.

2. Konkurrenca e vogël në procedurat e prokurimit publik

Numri mesatar i ofertave të pranuar është një nga treguesit kryesorë për vlerësimin e mënyrës në të cilën një autoritet kontraktues kryen prokurimin publik. Nëse konkurrenca është e vogël, kjo tregon se ka diskriminim në prokurim, gjegjësisht zbatim i kriterëve të papërshtatshme për përcaktimin e aftësisë së ofertuesve, specifikimet e favorshme të tenderit dhe kriteret e papërshtatshme për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme.

Analiza e të dhënave të marra nga ndërmarrjet dhe të shkarkuara nga Sistemi Elektronik i Prokurimit Publik tregon se ka përmirësim të konkurrencës në procedurat e prokurimit publik të ndërmarrjeve të synuara. Përkatësisht, në vitin 2019 numri mesatar i ofertave në një tender ka qenë 2.4 oferta, dhe në vitin 2020 ky numër u rrit në 2.8, dhe në gjysmën e parë të 2021 numri mesatar i ofertave në një tender është 2, 7. Kjo tregon prirje pozitive në promovimin e së cilës duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme, veçanërisht pasi numri mesatar i ofertave të pranuar në nivel kombëtar me vite është mbi 3 oferta për çdo tender.

Sa i përket konkurrencës, tenderët ku është pranuar vetëm një ofertë mund të konsiderohen si veçanërisht të rrezikshëm nga aspekti i korrupsionit. Gjegjësisht, këto kushte mund të jenë pasojë e zhvillimeve të tregut, por edhe të diskriminimit dhe mosrespektimit të detyrimeve ligjore në mënyrë që të sigurohet konkurrencë e ndershme midis ofertuesve.

Analiza e të dhënave tregon se në kompanitë e synuara në vitin 2019, në deri në 40% të tenderëve ka pasur vetëm një ofertë. Në vitin 2020, kjo zvogëlohet në 35% të tenderëve, dhe në gjysmën e parë të 2021, një ofertë është marrë për çdo tender të tretë (33%). Kjo tregon se ka përmirësim dhe prirje që duhet të vazhdojë.

Për të vlerësuar konkurrencën, është e rëndësishme që kompanitë të ndjekin dhe zbatojnë procedurën e negociuar pa publikuar njoftim. Sipas analizës së të dhënave nga procedurat e kryera në ndërmarrjet e synuara në një periudhë 2 vjeç e gjysmë, ka përparim edhe këtu, por duke pasur

parasysh kompleksitetin e çështjes, përmirësimet duhet të vazhdojnë. Të dhënat tregojnë se në vitin 2019 35% e kompanive të analizuara kanë kryer procedurë të negociuar pa publikuar njoftim, në vitin 2020 kjo është rrit në 45%, për t'u zvogëluar në vetëm 20% të kompanive në gjysmën e parë të 2021.

Veçanërisht problematike nga aspekti i ekzistimit të rrezikut nga korrupsionit janë dy bazat e mëposhtme: 1) negociata pa publikuar njoftim në bazë të urgjencës ekstreme dhe 2) negociata mbi bazë që prokurimi mund të kryhet vetëm nga një operator ekonomik. Megjithëse zbatimi i procedurës mbi këto dy baza kërkon mendimin e Byrosë për Furnizime Publike, dhe vetëm në situata të jashtëzakonshme mund të përdoret një procedurë e tillë pa mendimin e Byrosë, sidoqoftë një procedurë e tillë, sipas përkufizimit, si jo-transparent ofron mundësinë e korrupsionit.

3. Llogaridhënia e pamjaftueshme për marrëveshjet e lidhura dhe zbatimin e tyre

Transparenca dhe llogaridhënia në prokurimin publik vlerësohet duke publikuar njoftime për kontratat e lidhura të prokurimit publik brenda afatit ligjor, duke publikuar njoftime për kontratat e realizuara, duke dorëzuar të gjithë informacionin përkatës të kërkuar në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informacione Publike dhe duke publikuar të gjithë informacionin përkatës për prokurimin publik në ueb-faqet e kompanive, pra shoqërive aksionare.

Detyrimi për publikimin e njoftimeve për kontratën e lidhur dhe realizuar është i rregulluar ligjërisht dhe është shumë i thjeshtë për t'u zbatuar, d.m.th. nuk kërkon kohë dhe burime. Prandaj, nuk janë të qarta arsyet pse disa ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare për prokurime të caktuara të kryera publikojnë njoftimet me vonesë ose nuk i publikojnë ato fare.

Duke respektuar këto detyrime ligjore, nga njëra anë, autoritetet kontraktuese në fjalë do të tregojnë se duan të punojnë dhe se punojnë në përputhje me ligjin, dhe nga ana tjetër, do të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e prokurimit publik, dhe kështu edhe në rritjen e besimit të qytetarëve dhe përdoruesve të shërbimeve në ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare shtetërore.

Analiza e të dhënave tregon se në 49% të tenderëve nuk është respektuar afati prej 10 ditësh për dorëzimin e njoftimit për kontratën e lidhur dhe kontratën në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik (neni 70 i Ligjit për Prokurim Publik), situata në vitin 2020 mbeti e pandryshuar kurse në gjysmën e parë të 2021 është 38%. Kjo tregon se ka proces të përmirësimit të transparencës së ndërmarrjeve.

Situata është veçanërisht e pafavorshme në lidhje me detyrimin ligjor për të paraqitur njoftime në SEPP për një kontratë të realizuar. Shoqëritë aksionare dhe ndërmarrjet publike të themeluara nga Qeveria, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Kavadarit, Gostivarit dhe Strugës nuk e përmbushin plotësisht këtë detyrim, por prapëseprapë në këtë segment ka trende pozitive në vitin 2021.

Ligji për Prokurim Publik (neni 181 paragrafi 1 pika 7) parashikon gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë në denarë, e cila do t'i shqiptohet personit përgjegjës, gjegjësisht personit të autorizuar të personit juridik që është autoriteti kontraktues në rast se nuk i dorëzon njoftimet për kontratën e lidhur dhe njoftimet për kontratën e realizuar. Sidoqoftë, në praktikë nuk ka dijeni se që nga zbatimi i Ligjit të ri (Prill 2019), ndonjë autoritet kontraktues është ndëshkuar për mosrespektim e këtij detyrimi ligjor.

Në grupin e njoftimeve që duhet të publikohen janë njoftimet për anulimin e procedurës. Praktika tregon se, në raste të caktuara, as kjo nuk respektohet.

Në kontrast me publikimin e detyrueshëm në SEPP (i cili gjithashtu nuk është gjithmonë në përputhje me afatet ligjore), hulumtimet tregojnë se institucionet ende vullnetarisht publikojnë pak informacione dhe dokumente në faqet e tyre të internetit.

1. Përmirësimi i prokurimit publik në fazën e planifikimit

Duke u udhëhequr nga rregullat e përfshira në Ligjin për Prokurim Publik, veçanërisht në lidhje me atë se cilat lëndë dhe në cilat situata i nënshtrohen procedurës së prokurimit publik dhe në lidhje me periudhat kohore të nevojshme për të përgatitur dhe përfunduar llojin e duhur të procedurës së prokurimit publik, autoritetet duhet të miratojnë metodologji ose udhëzues për vlerësimin e nevojës për prokurim publik specifik dhe vlerën e tij. Aty duhet të theksohen udhëzime më specifike në lidhje me sigurimin në kohë të zbatimit të procedurave të prokurimit publik dhe nevojën për konsultime të tregut në mënyrë që të përcaktohet vlera e caktuar e prokurimit që korrespondon me çmimet e tregut. Në këtë mënyrë, institucionet do të detyrohen të kenë qasje më serioze në përcaktimin e fillimit të zbatimit të procedurës, si dhe në përcaktimin më të vërtet të vlerës së caktuar. Dhe me këtë kompanitë do të zhvillojnë udhëzime të tyre më të hollësishme për llogaritjen e vlerës së caktuar të prokurimit, dhe kjo do t'ju mundësoj atyre të marrin parasysh specifikat dhe natyrën e prokurimit që kanë.

Në krijimin e planeve të prokurimit publik, autoritetet kontraktuese nuk duhet të lidhen vetëm me kontrata të lidhura më parë për të njëjtin subjekt të prokurimit. Ata duhet të përdorin Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik si bazë të pasur të dhënash për prokurim në të gjithë vendin dhe informacione publike në dispozicion në internet.

Planet e prokurimit publik duhet të pasqyrojnë nevojat, por edhe mundësitë e vërteta financiare të kompanive në nivel kombëtar dhe lokal.

Të gjitha kompanitë duhet të prezantojnë sistem për monitorimin e zbatimit të planeve. Kjo do të mundësojë përmirësimin e realizimit të planeve të prokurimit publik, dhe do të ndikojë në zvogëlimin e ndryshimeve të shpeshta të planeve. Në të njëjtën kohë, sistemi për monitorimin e realizimit të planeve do t'u mundësojë atyre që janë përgjegjës për prokurimin publik të marrin parasysh përvojat nga realizimi i planeve të viteve të kaluara në përgatitjen e planeve të reja.

Ndryshimi i shpeshtë i planeve duhet të jetë një nga treguesit për kontrollin administrativ nga Byroja për Furnizime Publike, parashikuar nga Ligji i ri për Prokurimin Publik.

Planet për prokurim publik të publikohen në faqen e internetit të institucioneve. Për t'i mundësuar publikut që të ndjekë zbatimin e planeve të prokurimit publik, institucionet duhet të japin përshkrim të saktë të prokurimit, në vend që të përcaktojnë aktivitetet/kategoritë e përgjithshme, si ndërtimi dhe rindërtimi i rrugëve, prokurimi i softuerit, etj.

Shumë e rëndësishme është që planifikimi, si hapi i parë në proces, të dalë nga hapi i fundit në procesin e mëparshëm. Kjo do të thotë që analiza e brendshme e zhvilluar e procedurës së kryer më parë dhe kontrata e realizuar për subjektin e njëjtë ose të ngjashëm të prokurimit duhet të mundësojë vlerësim më të mirë për prokurimin e ri (nëse dhe kur është e nevojshme, në çfarë mase dhe për çfarë periudhe, sa fonde nevojiten , etj.).

2. Ndërmarrja e masave për të rritur konkurrencën

Personat e përfshirë në prokurim dhe institucionet në të cilat ata punojnë duhet të përdorin potencialet e Ligjit për Prokurimin Publik dhe të përpiqen të arrijnë parimet e përcaktuara në prokurimin publik: ekonomia, efikasiteti dhe efektiviteti i përdorimit të fondeve publike, konkurrenca midis operatorëve ekonomikë, transparencë, trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi i operatorëve ekonomikë dhe proporcionaliteti.

Çdo institucion, nga ana tjetër, duhet të përpiqet të zhvillojë tenderët në mënyrë që do të tërheqë sa më shumë kompani të interesuara dhe të rrisë konkurrencën në tenderë. Publiciteti, llogaridhënia dhe integriteti në prokurim janë një lloj garantuesi për konkurrencë më të lartë, dhe në përputhje me rrethanat, për cilësi më të lartë të mallrave, shërbimeve dhe punëve të furnizuara.

Për të stimuluar konkurrencën, kompanitë publike dhe shoqëritë aksionare duhet më shpesh të praktikojnë dialogun teknik, i cili me Ligjin e ri për Prokurim Publik është një mënyrë fakultative për t'u konsultuar me operatorët ekonomikë. Kjo formë e komunikimit midis autoritetit kontraktues dhe ofertuesve të mundshëm duhet të zbatohet në përgatitjen e prokurimeve më të larta në vlerë, por mbi të gjitha në prokurimet e planifikuara, pavarësisht nga vlera e tyre, për të cilat autoriteti kontraktues nuk e njeh situatën dhe pjesëmarrësit e tregut, ose ku ose lënda e prokurimit është e ndërlikuar, d.m.th. për përshkrimin e të cilave autoriteti kontraktues nuk ka ekspertizë të mjaftueshme.

Për të stimuluar konkurrencën nëpërmjet dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve teknike të përgatitura siç duhet, është e nevojshme jo vetëm të forconi kapacitetet e punonjësve në autoritetet kontraktore, por edhe të forconi kontrollin administrativ të Byrosë për Furnizime Publike duke zgjeruar fushën e procedurave të prokurimit publik, bazuar në vlerësimin e rreziqeve të shkeljes së dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe në procedurat e rastësishme. Në këtë mënyrë, autoritetet kontraktuese do të humbasin mundësinë për të shqyrtuar se në cilën procedurë do të jenë në gjendje të kenë kontroll administrativ nga Byroja e Furnizimeve Publike. Në këtë mënyrë, objektivisht do të forcohet përgjegjësia në nivel të institucioneve.

Një nga arsyet e zvogëlimit të konkurrencës janë marrëveshjet e paligjshme të kompanive mbi pjesëmarrjen e tyre në procedurat e prokurimit publik, çmimet dhe ndarjen e tregut. Prandaj, është e rëndësishme të vazhdohet me publikimin publik të procesverbalit të hapjeve publike ose emrave të kompanive ofertuese që do të shënohen në njoftimin e kontratës.

Në këtë mënyrë, publiku i prekur dhe publiku i gjerë do të njihet me operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurat specifike të prokurimit publik dhe kështu prokurimi do të jetë nën një kontroll edhe më të madh, dhe marrëveshja paraprake eventuale e kompanive do të parandalohet. Zbulimi publik i procesverbalit ekziston në platformën elektronike të prokurimit publik kroat. Procesverbali i hapjes publike të ofertave duhet t'i vihet në dispozicion publikut të gjerë, dhe jo vetëm atyre që kanë marrë pjesë në procedurë (ofertuesve). Për atë qëllim, është e nevojshme të mbindërtohet SEPP në mënyrë që publiku i gjerë të ketë qasje dhe njohuri në procesverbalin e hapjeve publike të bashkangjitura nga Komisioni i Prokurimit Publik.

3. Nxitja e transparencës së marrëveshjeve të lidhura dhe realizimi i tyre

Plotësimi dhe publikimi i njoftimeve për kontratën e lidhur dhe njoftimet për kontratën e realizuar brenda afateve rregullohen ligjërisht, prandaj është e nevojshme që themeluesit e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare shtetërore t'u tregojnë personave përgjegjës për respektimin e këtij detyrimi ligjor dhe të zbatojë sanksionet e përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik për shkelje të detyrimit në lidhje me publikimin e njoftimeve për kontratën e lidhur dhe njoftimet për kontratën e realizuar.

Nëse, përkundër indikacioneve dhe sanksioneve, këto detyrime vazhdojnë të mos respektohen në mënyrë të vazhdueshme, atëherë, siç është konfiguruar në SEPP se nuk mund të publikohet njoftim i ri për prokurim publik nëse pas skadimit të një periudhe të caktuar kohore nga procedura e përfunduar e prokurimit publik nuk është shpallur njoftim për kontrate të lidhur, kështu që mos të mundet të publikohet njoftim i ri për prokurim publik edhe për njoftim të pabotuar për kontratë të realizuar.

Sa i përket transparencës - një hap i madh përpara do të bëhej duke iu përmbajtur vazhdimisht rekomandimit për të publikuar sërë dokumentesh në internet-faqet e të gjitha institucioneve që kryejnë tenderë publikë. Në këtë drejtim, është e rëndësishme që kompanitë publike dhe shoqëritë aksionare të krijojnë seksion të veçantë mbi "prokurimin publik" në internet-faqet e tyre, në të cilën do të publikojnë dhe përditësojnë rregullisht të dhënat mbi planin e prokurimit publik me të gjitha ndryshimet, njoftimet për prokurim publik dhe njoftimet për kontratat e lidhura dhe të realizuara.

Për më tepër, është e nevojshme që të publikohen të gjitha të dhënat nga SEPP në format të hapur, gjë që do të mundësojë përdorimin dhe kuptimin më të lehtë të këtyre të dhënave. Në këtë mënyrë do të jetë e mundur të zhvillohen një mori analizash që tani mungojnë dhe që mund të shërbejnë si bazë për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit publik. Gjithashtu duhet të lidhen të dhënat nga SEPP me ato të Regjistrit Qendror, në mënyrë që të zbulohen keqpërdorimet e mundshme të tenderëve për qëllime korruptive.

